

FJALA E DEPUTETES ZHENI GJERGJI

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

Në mbështetje të nenit 75, pika 4, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, unë dhe kolegja ime, zonja Pampuri, propozojmë që në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2023” të bëhet ndryshimi si më poshtë vijon: në tabelën 4, treguesit fiskalë, bashkëlidhur me emërimin “total i shpenzimeve”, zëri 7, shpenzime të tjera ndihma ekonomike dhe paaftësia në kolonën e buxhetit 2023, “vlera 25 mijë e 950 lekë” të zëvendësohet me “vlerën 30 mijë lekë”. Natyrisht, ndihma ekonomike dhe pagesa për paaftësinë është një e drejtë dhe jo lëmoshë dhe, si e tillë, duhet të jetë në dispozicion të të gjithë individëve, që kanë nevoja dhe jetojnë në kushtet e minimumit jetik.

Gjatë vitit 2023 ndihma ekonomike do të reduktohet, do të ulet ndjeshëm numri i familjeve përfituese, nga 67 mijë familje, në 64 mijë, pra, 3 mijë familje më pak. Po ashtu, edhe vlera e fondit reduktohet me afro 500 milionë lekë më pak se 4,3 milionë euro; nga 6,82 miliardë lekë në vitin 2022, në 6,34 miliardë lekë në vitin 2023. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, niveli i varfërisë relative në Shqipëri arrin në 35% ose dy herë më i lartë se sa mesatarja e vendeve të rajonit dhe gati 6 herë më e lartë se sa mesatarja e vendeve të BE-së.

Ndërkohë, referuar raportit të UNICEF-it, efekti i rritjes së çmimeve ka krijuar mbi 40 mijë familje në varfëri ekstreme në Shqipëri deri në shtator të vitit 2022, çka dëshmon se niveli i varfërisë për vitin 2022 do të rritet mesatarisht 2-3 pikë përqindje më shumë, krahasuar me një vit më parë, një trend ky aspak pozitiv. Kujtojmë se qeveria prej 9 vjetësh refuzon kërkesën e vazhdueshme të grupeve të interesit dhe opozitës shqiptare për llogaritjen e minimumit jetik, në mënyrë që të adresohen saktë nevojat dhe pagesat për shtresat e pamundura. Shpenzimet për buxhetin për vitin 2023 për ndihmë ekonomike dhe aftësi të kufizuara kanë pësuar një rënie në raport me PBB-në, në nivelin 1,2% krahasuar me nivelin 1,5% në vitin 2020.

Si përfundim, mendojmë që në nenin 2 ky ndryshim të pasqyrohet në të gjitha nenet, tabelat, anekset shoqëruese, prandaj propozojmë dyfishimin e ndihmës ekonomike për 65 mijë familje përfituese që jetojnë në kushtet e minimumit jetik, duke rialokuar një fond prej 4 miliardë lekësh. Ky fond do të sigurohet nga fondi i rialokuar nga shpenzimet operative të qeverisjes qendrore dhe PPP-ve me mbështetje buxhetore. Qeveria duhet të heqë dorë nga shpenzimet e luksit dhe vetë ministria duhet të

rishikojë shpërndarjen buxhetore për t'u dhënë prioritet shqiptarëve para përfituesve të PPP-ve dhe koncesionarëve të regjistruar në ishujt offshore. Faleminderit!